<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Zëvendës Avokati i Përgjithshëm</b></p> <p>1. Zëvendës Avokati i Përgjithshëm i ndihmon Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror në udhëheqjen e Avokaturës Shtetërore, si dhe kryen detyra dhe përgjegjësitë të Avokatit të Përgjithshëm kur ai apo ajo mungon. Zëvendës Avokati i Përgjithshëm ka autoritet të plotë për të vepruar në emër të Avokaturës Shtetërore në rast të mungesës apo paaftësisë së Avokatit të Përgjithshëm. Zv Avokati i Pwrgjithshwm, ka kualifikime, dhe pwrgegjwsi tw barabarta me Avokatin Shtetwror</p> <p>2. Zëvendës Avokati i Përgjithshëm kryen edhe punë tjera të cilat i delegohen nga Avokati i Përgjithshëm Shtetëror.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Deputy State Advocate General</b></p> <p>1.The Deputy Advocate General assists the State Advocate General in leading the State Advocacy Office, as well as performs the duties and responsibilities of the Advocate General when he or she is absent. The Deputy Advocate General has full authority to act on behalf of the State Advocacy Office in case of absence or incapacity of the Advocate General. Deputy Advocate General has same qualifications as the Advocate General.</p> <p>2.The Deputy Advocate General also performs other tasks which are delegated to him/her by the State Advocate General.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Zamenik Generalnog advokata</b></p> <p>1. Zamenik Generalnog advokata pomaže Generalnom Državnom advokatu u vođenju Državne advokature, i obavlja poslove i odgovornosti Generalnog advokata kada je on ili ona odsutan. Zamenik Generalnog advokata ima puna ovlašćenja da postupa u ime Državne advokature u slučaju odsustva ili sprečenosti Generalnog advokata. Zamenik i Generalni advokat imaju iste kvalifikacije.</p> <p>2. Zamenik Generalnog advokata obavlja i druge poslove koje mu poveri Generalni Državni advokat.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Avokati shtetëror</b></p> <p>1. Funksionin e avokatit shtetëror e ushtrojnë avokatët shtetëror në Avokaturën Shtetërore.</p> <p>2. Në kryerjen e punëve të përfaqësimit, Avokati Shtetëror, është i pavarur si dhe është i autorizuar të ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr pala në procedurë me synim të mbrojtjes së interesit</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>State Advocates</b></p> <p>1. State Advocates of the State Advocacy Office exercise the function of state advocates.</p> <p>2. In performing representation jobs, State Advocates are independent and authorized to take all actions which a party to the proceeding undertakes, for purposes of protecting the interests of the party they</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Državni advokat</b></p> <p>1. Funkciju državnog advokata obavljaju državni advokati u Državnoj advokaturi.</p> <p>2. U vršenju radnji zastupanja, Državni advokat je samostalan i ovlašćen je da preduzima sve radnje koje preduzme stranka u postupku u cilju zaštite interesa stranke koju zastupa, u skladu sa važećim</p>

<p>të palës të cilën e përfaqëson, në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>3. Avokati shtetërorë e informon rregullisht Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror për gjendjen dhe zhvillimet në lëndët të cilat u janë caktuar.</p> <p>4. Avokati Shtetëror i raporton rregullisht Ministrin të Drejtësisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Raportimi i Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror</b></p> <p>1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, i paraqet raport tremujor Ministrin të Drejtësisë lidhur me gjendjen dhe rezultatin e përfaqësimit të lëndëve..</p> <p>2. Përveç raporteve sipas paragrafit 1 të këtij neni, Avokati i Përgjithshëm shtetëror raporton edhe në periudha tjera kur i kërkohet nga Ministri.</p> <p>3. Avokati Shtetëror duhet të informojë Ministrin lidhur me të gjitha procedurat që janë në zhvillim e sipër, në veçanti të atyre të ndërlidhura me procedurat e arbitrazhit, si dhe të atyre me interes shtetëror.</p>	<p>represent, in accordance with the applicable legislation.</p> <p>3. State Advocates inform the State Advocate General regularly on the situation and developments of cases they have been assigned.</p> <p>4. The Advocate General reports regularly to the Minister of Justice.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Reporting of the State Advocate General</b></p> <p>1. The State Advocate General submits a report to the Minister of Justice regarding the situation of case representation, every three months.</p> <p>2. In addition to the reports according to paragraph 1 of this Article, the State Advocate General reports in other periods when requested by the Minister.</p> <p>3. The State Advocate must inform the Minister about all ongoing proceedings, in particular those related to arbitration proceedings, as well as those of state interest.</p>	<p>zakonodavstvom.</p> <p>3. Državni advokat redovno obaveštava Generalnog Državnog advokata o stanju i razvoju predmeta koji su mu određeni.</p> <p>4. Državni advokat izveštava redovno Ministra pravde.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Izveštavanje Generalnog Državnog advokata</b></p> <p>1. Generalni Državni advokat podnosi izveštaj Ministru pravde o stanju zastupljenosti predmeta, svaka tri meseca.</p> <p>2. Pored izveštaja iz stava 1 ovog Člana, Generalni Državni advokat izveštava iu drugim periodima na zahtev ministra.</p> <p>3. Državni advokat je dužan da obavesti ministra o svim postupcima koji su u toku, a posebno o postupcima koji se odnose na arbitražne postupke, kao i o postupcima od državnog interesa.</p>
--	--	--

<p>4. Raporti duhet t'i përmbajë të gjitha informatat lidhur me gjendjen reale të përfaqësimit të lëndëve, aktiviteteve dhe punëve të kryera brenda fushë veprimtarisë nga avokatët shtetëror.</p>	<p>4. The report should contain all the information regarding the real situation of case representation, activities and works performed within the field of activity by state advocates.</p>	<p>4. Izveštaj treba da sadrži sve informacije o realnom stanju zastupanja predmeta, aktivnosti i poslova izvršenih u okviru oblasti delatnosti od državnih advokata.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 16 Përjashtimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16 Disqualification</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16 Razrešenje</b></p>
<p>Rregullat e procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve, përshtatshmërisht zbatohen edhe për përjashtimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, Zëvendës Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror si dhe avokatit shtetërorë.</p>	<p>Rules of contested procedure for disqualification of judges apply accordingly also for the disqualification of the State Advocate General, the Deputy State Advocate General and the State Advocates.</p>	<p>Pravila parničnog postupka za razrešenje sudija, shodno se primenjuju i za razrešenje Generalnog Državnog advokata, Zamenika Generalnog Državnog advokata i Državnog advokata.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 17 Konflikti i interesit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17 Conflict of interest</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17 Sukob interesa</b></p>
<p>Gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, Zëvendës Avokati i Përgjithshëm Shtetëror si dhe avokati shtetëror nuk mund t'i përfaqësojnë autoritetet publike nëse ka interes personal direkt ose indirekt në rast.</p>	<p>In exercising his/her public functions, the State Advocate General, the Deputy State Advocate General and any State Advocate may not represent the public authorities if he has a personal interest, direct or indirect, in a case.</p>	<p>U vršenju javne funkcije, Generalni Državni advokat, Zamenik Generalnog Državnog advokata i Državni advokat ne mogu predstavljati organe javne vlasti ako imaju direktan ili indirektan lični interes u predmetu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 18 Papajtueshmëria</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 18 Incompatibility</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 18 Neusaglašenost</b></p>
<p>1. Avokati i Përgjithshëm, Zëvendës Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët</p>	<p>1. The Advocate General, the Deputy State Advocate General and the state advocates</p>	<p>1. Generalni Državni advokat, Zamenik Generalnog Državnog advokata i Državni</p>

<p>shtetërorë nuk mund të jenë anëtarë të organeve të asnjë partie politike e as të ushtrorë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale që bie ndesh me funksionin që janë duke e ushtruar.</p> <p>2. Avokati i Përgjithshëm, Zëvendës Avokati i Përgjithshëm Shtetëror si dhe avokatët shtetërorë mund të merren me veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre dhe me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>may not be members of the bodies of any political party nor exercise political, official or private professional activities that conflict with the function they are exercising.</p> <p>2. The Advocate General, the Deputy State Advocate General as well as the state advocates may engage in scientific, cultural, academic and other activities, which do not conflict with their functions and the legislation in force.</p>	<p>advokati ne mogu biti članovi organa bilo koje političke stranke, niti mogu obavljati političke, državne ili privatne profesionalne aktivnosti koje su u suprotnosti sa funkcijom koju obavljaju.</p> <p>2. Generalni Državni advokat, Zamenik Generalnog Državnog advokata i Državni advokati mogu da se bave naučnim, kulturnim, akademskim i drugim delatnostima koji nisu u suprotnosti sa njihovim funkcijama i važećem zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Shpenzimet e përfaqësimit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Representation costs</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Troškovi zastupanja</b></p>
<p>Shpenzimet e përfaqësimit nga ana e Avokatit të Përgjithshëm shtetëror dhe avokatëve shtetërorë i bart Avokatura Shtetërore, ndërsa për nivelin lokal i bartë komuna.</p>	<p>Representation costs by the State Advocate General and State Advocates shall be covered by the State Advocacy Office, and by the municipality for representation of the local level.</p>	<p>Troškove zastupanja od strane Generalnog Državnog advokata i Državnih advokata snosi Državna advokatura, dok za lokalni nivo snosi opština.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Obligimi për bashkëpunim</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Obligation to cooperate</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Obaveza saradnje</b></p>
<p>1. Me rastin e përfaqësimit të organeve të administratës shtetërore apo institucioneve të pavarura, sipas dispozitave të këtij ligji, organi përkatës obligohet të bashkëpunojë dhe t'i përgjigjet kërkesave të Avokaturës</p>	<p>1. In cases of representing state administration bodies or independent institutions, according to the provisions of this law, the relevant body is obliged to cooperate and respond to the requests of the</p>	<p>1. U slučaju zastupanja organa državne uprave ili nezavisnih institucija, prema odredbama ovog zakona, nadležni organ je dužan da saraduje i odgovara na zahteve</p>



<p>Shtetërore, në pajtim me afatet ligjore përkatësisht gjyqësore.</p> <p>2. Të gjithë zyrtarët, nëpunësit civil, punonjësit dhe kontraktuesit e autoriteteve përkatëse që janë shprehimisht të detyruar që të bashkëpunojnë plotësisht me Avokaturën Shtetërore duhet t’u përgjigjen kërkesave të saj për dokumentet apo informatat.</p> <p>3. Në rast se institucionet e administratës shtetërore nuk respektojnë kërkesën e Avokaturës Shtetërore, nen, Avokatura njofton Kryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë, duke mbështetur pretendimin me provat përcjellëse.</p> <p><b>KREU III - EMËRIMI DHE PUSHIMI NGA FUNKSIONI</b></p> <p><b>Neni 21</b> <b>Emërimi i Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror dhe i Avokatëve Shtetëror</b></p>	<p>State Advocacy Office, in accordance with the legal or judicial deadlines.</p> <p>2. All officials, civil servants, employees and contractors of the relevant authorities who are explicitly obliged to fully cooperate with the State Advocacy Office must respond to its requests for documents or information.</p> <p>3. In case the state administration institutions do not comply with paragraph 1 of this Article, the State Advocacy Office shall notify the Prime Minister and the Minister of Justice, supporting their claim with evidence.</p> <p><b>CHAPTER III - APPOINTMENT AND DISMISSAL FROM FUNCTION</b></p> <p><b>Article 21</b> <b>Appointment of the State Advocate General and State Advocates</b></p>	<p>Državne advokature, u skladu sa zakonskim ili sudskim rokovima.</p> <p>2. Svi javni službenici, civilni službenici, zaposleni i izvođači radova dotičnih organa koji su izričito dužni da u potpunosti sarađuju sa Državnom advokaturom moraju odgovoriti na njene zahteve za dokumentima ili informacijama. Nesaradnja sa pravne tačke gledišta dovoljan je osnov da Državna advokatura zatraži pokretanje relevantnog pravnog postupka.</p> <p>3. U slučaju da organi državne uprave ne poštuju stav 1 ovog Člana, Državna advokatura obaveštava Premijera i Ministra pravde, uz relevantnu propratnu dokumentaciju u svrsi dokaza.</p> <p><b>POGLAVLJE III - IMENOVANJE I RAZREŠENJE SA FUNKCIJE</b></p> <p><b>Član 21</b> <b>Imenovanje Generalnog Državnog advokata i Državnih advokata</b></p>
--	---	---

<p>1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe Zëvendës Avokati i Përgjithshëm Shtetëror nuk janë zyrtarë publik dhe emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Drejtësisë.</p> <p>2.Mandati I Avokatit Shtetëror dhe zëvendës Avokatit Shtetëror është 7 vite.</p> <p>3.Avokati Shtetëror dhe zëvendës Avokati Shtetëror shkarkohet nga Ministri vetëm atëherë kur vërtetohet paaftësia profesionale, keqpërdorimi, keqmenaxhimi apo shkaktimi i dëmit të drejtpërdrejtë ndaj interesave shtetërorë.</p>	<p>1. The State Advocate General and the Deputy State Advocate General shall be appointed and dismissed by the Mnister of Justice.are not public officials and are appointed by the Minister of Justice.</p> <p>2.The mandate of the Advocate General and deputy advocate general is 5 years.</p> <p>3.The Advocate General and deputy Advocate General shall be dismissed only in cases of professional incapacity, misuse, mismanagement or in cases of damage caused directly to the state interests.</p>	<p>1. Generalni Državni advokat i Zamenik Generalnog Državnog advokata nisu državni službenici I bivaju imenovani i razrešeni od strane Ministra pravde.,</p> <p>2.Mandat generalnog advokata i njegovog zemenika jeste 5 godina.</p> <p>3.Generalni advokat i njegov zamenik će biti razrešeni dužnosti u slučaju profesionalne nesposobnosti, zloupotrebe, lošeg menadžmenta ili štete prouzrokovane direktno protiv državnih interesa.</p>
<p><b>Neni 22</b> <b>Kushtet për emërim</b></p>	<p><b>Article 22</b> <b>Criteria for appointment</b></p>	<p><b>Član 22</b> <b>Uslovi za imenovanje</b></p>
<p>1. Avokat shtetëror mund të emërohet çdo person i cili plotëson këto kushte:</p> <p>1.1. të jetë jurist i diplomuar;</p> <p>1.2. të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;</p>	<p>1. Any citizen who meets the following specific criteria in addition to the criteria provided by the Law on Public Officials may be appointed as a State Advocate:</p> <p>1.1. has a university degree in law;</p> <p>1.2. has passed the bar examination;</p>	<p>1. Za državnog advokata može se imenovati svako lice koje, pored uslova predviđenih Zakonom o Javnim službenicima, ispunjava i sledeće posebne uslove:</p> <p>1.1. biti diplomirani pravnik;</p> <p>1.2. imati položen pravosudni ispit;</p>

<p>1.3. të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune në fushën juridikeë</p> <p>1.4.të ketë integritet të lartë moral dhe profesional</p>	<p>1.3. has at least 10 (ten) years of work experience in the field of lawë</p> <p>1.4.has high moral and professional integrity.</p>	<p>1.3. imati najmanje 10 (deset) godina radnog iskustva u pravnoj oblasti;</p> <p>1.4.poseduje visak nivo profesionalnog i moralnog integriteta</p>
<p><b>KREU IV - TË PUNËSUARIT NË AVOKATURËN SHETËTËRORE</b></p>	<p><b>CHAPTER IV - EMPLOYEES OF THE STATE ADVOCACY OFFICE</b></p>	<p><b>POGLAVLJE IV - ZAPOSLENI U DRŽAVNOJ ADVOKATURI</b></p>
<p><b>Neni 23</b> <b>Personeli civil në Avokaturën Shtetërore</b></p>	<p><b>Article 23</b> <b>Civil personnel in the State Advocacy Office</b></p>	<p><b>Član 23</b> <b>Civilno osoblje u Državnoj advokaturi</b></p>
<p>1. Avokatura Shtetërore ka numër të caktuar të nëpunësve civil për kryerjen e punëve profesionale dhe administrativo-teknike.</p> <p>2. Avokatura Shtetërore mund të punësojë numër të caktuar të bashkëpunëtorëve profesional të cilët iu ndihmojnë bartësve të funksioneve në kryerjen e punëve juridike. Bashkëpunëtorët profesionalë duhet të kenë të mbaruar nivelin master të studimeve me së paku 3 vite përvojë pune në çështjet juridike dhe të flasin dhe përdorin gjuhën angleze.</p>	<p>1. In the State Advocacy Office, there are a certain number of civil servants who perform professional and technical-administrative duties.</p> <p>2. The State Advocacy Office may employ a certain number of professional officers who help the office-holders to perform legal work.Such professional officers shall have master level of finished studies, at least 3 years of experience in legal field, and shall be able to speak and use English language..</p>	<p>1. Državna advokatura ima određen broj civilnih službenika za obavljanje stručnih i administrativno-tehničkih poslova.</p> <p>2. Državna advokatura može zaposliti određeni broj stručnih saradnika koji pomažu nosiocima funkcija u obavljanju pravnih poslova. Takvi stručni saradnici trebaju posedovati diploma master studija, imati najmanje tri godine radnog iskustva na pravnim poslovima te umeti govoriti i pisati engleski jezik.</p>

<p>3. Numri i nëpunësve civil në Avokaturën Shtetërore përcaktohet me aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Avokaturës Shtetërore.</p> <p>4. Të punësuarit në Avokaturën Shtetërore janë nëpunës civil dhe për çështjet e personelit zbatohen përshtatshëm dispoziat e Ligjit përkatës për Shërbimin Civil.</p>	<p>3. The number of civil servants at the State Advocacy Office is determined by the act for internal organization and systematization of work of the State Advocacy Office.</p> <p>4. Employees at the State Advocacy Office are civil workers and the provisions of the relevant Law on Civil Service shall apply accordingly for personnel issues.</p>	<p>3. Broj civilnih službenika u Državnoj advokaturi utvrđuje se aktom o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta Državne advokature.</p> <p>4. Zaposleni u Državnoj advokaturi su civilni službenici i na pitanja osoblja se na odgovarajući način primenjuju odredbe relevantnog Zakona o Civilnoj službi.</p>
<p><b>Neni 24</b> <b>Aftësimi profesional</b></p>	<p><b>Article 24</b> <b>Professional training</b></p>	<p><b>Član 24</b> <b>Stručno osposobljavanje</b></p>
<p>1. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, Zëvendës Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, avokatët shtetëror si dhe nëpunësit civil në Avokaturën Shtetërore, kanë të drejtë dhe detyrim në arsim dhe aftësim profesional të vazhdueshëm.</p> <p>2. Për nevoja të arsimit dhe aftësimit profesional sigurohen mjetet e nevojshme të cilat janë të parapara në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të ndara për Avokaturën Shtetërore.</p>	<p>1. The State Advocate General, Deputy State Advocate General, state advocates and civil servants in the State Advocacy Office shall have the right and duty to continuous professional training and education.</p> <p>2. For professional training and education needs, necessary means are provided which are foreseen in the Budget of the Ministry of Justice and allocated for the State Advocacy Office.</p>	<p>1. Generalni Državni advokat, Zamenik Generalnog Državnog advokata, Državni advokati kao i Civilni službenici u Državnoj advokaturi, imaju prava i obaveze u kontinuiranom obrazovanju i stručnom osposobljavanju.</p> <p>2. Za potrebe obrazovanja i stručnog osposobljavanja obezbeđena su neophodna sredstva koja su predviđena budžetom Ministarstva pravde i namenjena Državnoj advokaturi.</p>
<p><b>Neni 25</b> <b>Vlerësimi i punës profesionale</b></p>	<p><b>Article 25</b> <b>Evaluation of professional work</b></p>	<p><b>Član 25</b> <b>Ocenjivanje stručnog rada</b></p>
<p>1. Çdo gjashtw muaj avokatët shtetëror i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të punës profesionale, i cili kryhet nga Avokati</p>	<p>1. Every six months, State Advocates shall be subject to a professional work evaluation procedure to be conducted by the State</p>	<p>1. Svakih šest meseci, Državni advokati prolaze kroz postupak ocenjivanja stručnog rada, koji se sprovodi od Generalnog</p>

<p>i Përgjithshëm Shtetëror, i cili merr parasysh rezultatet e arritura gjatë procedurave gjyqësore dhe përfaqësimeve të kryera gjatë periudhës së vlerësimit. Vlerësimin e mbikqyr dhe aprovon Ministri I Drejtësisë.</p> <p>2. Vlerësimi me të cilin konstatohet paaftësi profesionalepërbën shkak për inicim të shkarkimit të një avokati shtetëror.</p>	<p>Advocate General, which shall take into consideration results achieved in litigations and representations performed during the period under evaluation. The evaluation of the state advocates is made by the Minister.</p> <p>2. The assessment ascertaining professional incompetence constitutes grounds for initiating the dismissal of a state advocate.</p>	<p>Državnog advokata, uzimajući u obzir rezultate postignute u sudskim postupcima i zastupanja obavljenih u toku perioda ocenjivanja. Za ocenjivanje je odgovoran Ministar.</p> <p>2. Ocenjivanje kojom se utvrđuje stručna nesposobnost predstavlja razlog za pokretanje postupka za razrešenje državnog advokata.</p>
<p><b>KREU V - PËRFAQËSIMI I NIVELIT LOKAL</b></p> <p><b>Neni 26</b> <b>Avokati i komunës</b></p>	<p><b>CHAPTER V - REPRESENTATION OF LOCAL LEVEL</b></p> <p><b>Article 26</b> <b>Municipal Advocate</b></p>	<p><b>POGLAVLJE V - ZASTUPANJE LOKALNOG NIVOA</b></p> <p><b>Član 26</b> <b>Opštinski advokat</b></p>
<p>1. Avokati i komunës përfaqëson dhe mbron komunën në të gjitha çështjet ku komuna paraqitet si palë në procedurë.</p> <p>2. Avokati i komunës emërohet me konkurs të hapur publik nga Kryetari i Komunës, sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë.</p> <p>3. Avokati i komunës vepron i pavarur në kuptimin funksional dhe administrativ në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje</p>	<p>1. The municipal advocate shall represent and defend the municipality in all cases where the municipality appears as a party in the procedure.</p> <p>2. The Municipal Advocate shall be appointed by an open, public competition by the Mayor, in accordance with the provisions of the Law on Public Officials.</p> <p>3. The Municipal Advocate shall act independently in the functional and administrative sense, in accordance with the</p>	<p>1. Opštinski advokat zastupa i brani opštinu u svim slučajevima u kojima se opština pojavljuje kao stranka u postupku.</p> <p>2. Opštinskog advokata imenuje Predsednik opštine na javnom konkursu, u skladu sa odredbama Zakona o javnim službenicima.</p> <p>3. Opštinski advokat deluje samostalno u funkcionalnom i administrativnom smislu u</p>

<p>Lokale dhe për punën e tyre i përgjigjen Kryetarit të Komunës.</p> <p>4. Struktura organizative e nivelit lokal rregullohet me akt nënligjor, të cilin e miraton Kuvendi Komunal.</p> <p>5. Avokati i komunës e njofton Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror lidhur me ndërmarrjen e veprimeve procedurale për mbrojtjen e interesit të Komunës, aktiviteteve dhe punëve të kryera brenda fushë veprimtarisë së tyre.</p> <p>6. Pavarësisht dispozitave të këtij ligji, në rastet kur kontesti në nivelin komunal është i shumës mbi 200,000 euro, atëherë avokati i komunës e njofton Avokaturën Shtetërore për këtë dhe kjo e fundit vendos, nëse rasti do të përfaqësohet nga avokati shtetëror apo avokati i komunës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Zbatimi përshtatshmërisht</b></p> <p>Të gjitha dispozitat që vlejné për avokatët shtetërorë, aty ku mund të zbatohet përshtatshmërisht, vlejné edhe për avokatët e komunës.</p>	<p>Law on Local Self-Governance and reports to the Mayor.</p> <p>4.The organizational structure of the local level shall be regulated by a sub-legal act, which is adopted by the Municipal Assembly.</p> <p>5.The Municipal Advocate notifies the State Advocate General regarding the undertaking of procedural actions for the protection of the interest of the Municipality, the activities and works performed within their scope of activity.</p> <p>6.Notwithstanding the provisions of this law, in cases when disputes at the municipal level are in the amount of over €200,000, then the Municipal Advocate notifies the State Advocate and the latter decides whether the case will be represented by a state advocate or a municipal advocate.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Appropriate implementation</b></p> <p>The provisions of this law applicable to state advocates where possible, are applicable to municipal advocates as well.</p>	<p>skladu sa Zakonom o lokalnoj samoupravi i za svoj rad odgovara Predsedniku opštine.</p> <p>4.Organizaciona struktura lokalnog nivoa uređuje se podzakonskim aktom, koji usvaja Skupština opštine.</p> <p>5.Opštinski advokat obaveštava Generalnog Državnog advokata o preduzimanju proceduralnih radnji za zaštitu interesa opštine, aktivnostima i poslovima izvršenih u okviru njihove oblasti delatnosti.</p> <p>6.Bez obzira na odredbe ovog zakona, u slučajevima kada je spor na opštinskom nivou u iznosu većem od 200,000 evra, u tom slučaju opštinski advokat obaveštava o tome Državnu advokaturu i ona odlučuje da li će se predmet zastupati od Državnog advokata ili Opštinskog advokata.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Odgovarajući način primene</b></p> <p>Odredbe ovog zakona koje se primenjuju nad državnim advokatima, tamo gde je moguće, bivaju primenjene i nad opštinskim advokaatima..</p>
--	--	---

<b>KREU VI - DISPOZITAT KALIMTARE PËRFUNDIMTARE</b>	<b>CHAPTER VI - TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</b>	<b>POGLAVLJE VI - PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 31 Aktet nënligjore</b></p> <p>Brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi të këtij Ligji, do të nxirren aktet nënligjore të parapara me këtë ligj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 28 Sub-legal acts</b></p> <p>Within six (6) months after the entry into force of this Law, the sub-legal acts foreseen by this law shall be issued.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 28 Podzakonski akti</b></p> <p>1.U roku od šest (6) meseci od dana stupanja na snagu ovog zakona doneće se sledeća podzakonska akta predviđena ovim zakonom</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 29 Shfuqizimi</b></p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 04/l-157 për Avokaturën Shtetërore.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 29 Abolishment</b></p> <p>Law No. 04/L-157 on the State Advocacy Office is abolished on the day this Law enters into force.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 29 Stavljanje van snage</b></p> <p>Stupanjem na snagu ovog zakona, stavlja se van snage Zakon br. 04/l-157 o Državnoj advokaturi.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 30 Hyrja në Fuqi</b></p> <p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30 Entry into force</b></p> <p>This Law shall enter into force fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30 Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: right;">Glauk Konjufca</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p style="text-align: right;">Glauk Konjufca</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Speaker of the Assembly of the Republic of Kosova</p>	<p style="text-align: right;">Glauk Konjufca</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Predsednik Skupštine Republike Kosova</p>